



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. ____, datë ____.2025

**PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VEÇANTA DHE PROCEDURAVE PËR
PËRZGJEDHJEN, EMËRIMIN, VLERËSIMIN E REZULTATEVE NË PUNË,
DISIPLINËN, LIRIMIN DHE SHKARKIMIN NGA DETYRA TË INSPEKTORIT TË
PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 pika 2, të ligjit nr. 99/2024, datë 12.09.2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky vendim përcakton kriteret e veçanta dhe procedurat për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, lirimin dhe shkarkimin nga detyra të inspektorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

II. KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN DHE EMËRIMIN

Kandidati për inspektor të Përgjithshëm krahë kriterëve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 16 të ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", duhet të plotësojë edhe këto kriterë të veçanta:

- a. Të ketë diplomë të nivelit "Master i Shkencave" ose "Master Profesional" shkenca juridike, shkenca natyrore, shkenca inxhinierike, shkenca mjekësore dhe shëndetësore, dhe shkenca bujqësore;
- b. Të ketë ushtruar jo më pak se 5 (pesë) vjet në funksionin drejtor drejtorie në Inspektorat të Përgjithshëm ose në funksionin kryeinspektor në inspektoratin qendror, ose të dyja këto funksione gjatë kësaj periudhe;

III. PROCEDURA E PËRZGJEDHJES DHE EMËRIMIT

1. Për pozicionin vakant të inspektorit të Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm, brenda një afati prej 30 (tri dhjetë) ditësh, hap thirrjen për aplikim dhe ngre një komision *ad hoc* të përbërë nga:
 - a. Një përfaqësues i Kryeministrit;
 - b. Një përfaqësues i Departamentit të Administratës Publike;
 - c. Një përfaqësues nga jeta akademike, Universiteti i Tiranës, me përparësi Ministria e Drejtësisë ose ndonjë tjetër.
2. Njoftimi për aplikim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të Kryeministrit dhe qëndron i hapur për një periudhë jo më pak se 15 (pësemëdhjetë) ditë kalendarike.
3. Kandidati paraqet këto dokumente:
 - a. Kërkesë për aplikim;
 - b. Jetëshkrim të përditësuar (CV);
 - c. Kopje të diplomës dhe listës së notave;
 - ç) Dëshmi të përvojës profesionale;
 - d. Vetëdeklarim për konfliktin e interesit dhe papajtueshmëri sipas legjislacionit në fuqi;
 - dh) Formularin e vetëvlerësimit.
4. Komisioni *ad hoc* përfundon shqyrtimin e dokumentacionit dhe zhvillimin e intervistave me kandidatët, brenda një afati jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikimeve.
5. Vlerësimi i kandidatëve përbëhet nga:
 - a. Vlerësimi i dokumentacionit dhe përvojës profesionale: deri në 70 pikë;
 - b. Intervista e strukturuar me gojë: deri në 30 pikë.
6. Vlerësimi i dokumentacionit dhe përvojës profesionale deri në 70 pikë realizohet sipas skemës së mëposhtme:
 - a. Niveli i arsimit master i shkencave ose profesional sipas parashikimeve në shkronjën "a" të kreut II, të këtij vendimi: deri në 30 pikë.
 - b. Përvojë pune si drejtues në institucione publike apo private, si dhe në inspektorate ose struktura të lidhura me inspektimin: deri në 10 pikë.
 - c. Publikime, angazhime akademike, pjesëmarrje në grupet e hartimit të politikave ose akteve në fushën e inspektimeve: deri në 10 pikë.
 - ç. Trajnime dhe kualifikime profesionale të lidhura me fushën e inspektimit dhe administrimit publik: deri në 10 pikë.
 - d. Integriteti profesional në bazë të deklaratave, referencave dhe dokumentacionit plotësues: deri në 10 pikë.
7. Komisioni harton listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar, të shoqëruar me renditjen sipas pikëve të grumbulluara, dhe ia paraqet Kryeministrit brenda 3 (tre) ditëve pune nga përfundimi i procesit të vlerësimit.
8. Komisioni *ad hoc* funksionon në përputhje me këto rregulla:
 - a) Mbledhjet janë të vlefshme kur marrin pjesë të gjithë anëtarët;

- b) Vendimmarrja bëhet me shumicë votash;
 - c) Çdo anëtar nënshkruan një deklaratë mbi mungesën e konfliktit të interesit para fillimit të vlerësimit;
 - ç) Në rast mungese të një anëtari, zëvendësimi bëhet nga institucioni përkatës brenda 3 (tre) ditëve;
9. Komisioni garanton barazi, objektivitet dhe transparencë gjatë gjithë procesit të vlerësimit.
10. Inspektori i Përgjithshëm emërohet në detyrë me propozim të Kryeministrit dhe vendim të Këshillit të Ministrave.

IV. MASAT DISIPLINORE DHE PROCEDURA PËR SHKARKIMIN

1. Sekretari i Përgjithshëm në Kryeministri me iniciativë të tij ose pas informacionit zyrtar të ardhur nga institucione shtetërore, vendos fillimin e procedurës disiplinore dhe njofton me shkrim inspektorin e Përgjithshëm për shkeljen e dyshuar dhe fillimin e hetimit administrativ.
2. Në rastet kur ka indicie të arsyeshme për shkelje të rënda ose të përsëritura që mund të ndikojnë në funksionimin e rregullt të institucionit.
3. Sekretari i Përgjithshëm urdhëron ngritjen e një grupi të posaçëm për hetimin administrativ, duke mbledhur prova, dëshmi, raportime dhe deklarata, sipas natyrës së shkeljes së pretenduar.
4. Inspektori i Përgjithshëm ka këto të drejta:
 - a. të paraqesë shpjegime me shkrim;
 - b. të zhvillojë një dëgjese me grupin e posaçëm, brenda një afati jo më të gjatë se 10 ditë pune nga data e njoftimit;
 - c. të përfaqësohet nga përfaqësues ligjor.
5. Pas përfundimit të hetimit, grupi i posaçëm përgatit një raport përfundimtar, i cili i paraqitet Sekretarit të Përgjithshëm, brenda 10 ditëve pune nga data e përfundimit të këtij hetimi.
6. Sekretari i Përgjithshëm, pas administrimit të raportit përfundimtar, i njofton Kryeministrit rezultatet e raportit të grupit të posaçëm.

V. LIRIMI DHE SHKARKIMI NGA DETYRA

1. Inspektori i Përgjithshëm lirohet dhe shkarkohet nga detyra me propozim të Kryeministrit dhe vendim të Këshillit të Ministrave, sipas rasteve të parashikuara në ligjin nr. 99/2024, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA